

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Lazarati te Kanadaja, trafikimi i kanabisit në Shqipëri
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392397.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:31:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	18 shtator 2026, 06:22:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 18 shtator 2026, 06:21:00 UTC → 18 shtator 2026, 06:23:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	78f004268b568dbb7acf8e6a3e8b1e4f2ce7717596e2c9aed66f7dd1028c16c6
TEKSTI	7dcc05b40c2f5fbbc8638ab529d57d8cd7ae579d6de928af9a0cb898d691288e
PAMJA	1d759fc5ebffb1c1eedac65af554051914e4be3a655af76c6bfd198cfbc86b00

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	22da0cf5d4911b7a7ad0b23497762bf6359c8cf8905700f0d9f2a8c77e3bfd2b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/22da0cf5d4911b7a7ad0b23497762bf6359c8cf8905700f0d9f2a8c77e3bfd2b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nga Lazarati te Kanadaja, trafikimi i kanabisit në Shqipëri

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 18.09.2026, 08:22

Share Share

Nga Lazarati te Kanadaja, trafikimi i kanabisit në Shqipëri

Brenda vetëm 19 ditësh, nga 22 gushti deri më 9 shtator, autoritetet shqiptare sekuestruan 233.7 kilogramë kanabis të nisur nga Kanadaja. Dy prej ngarkesave, gjithsej 187.7 kg, u kapën në Portin e Durrësit, ndërsa 46 kg të tjera u zbuluan në aeroportin e Rinasit, të fshehura në valixhe. Sipas Policisë së Shtetit, dy ngarkesat e kapura në Durrës kishin një vlerë tregu prej rreth 2.2 milionë eurosh dhe përmbanin kanabis të llojit "Gelato", i njohur për përqendrimin e lartë të THC-së. Droga dyshohet se ishte siguruar në Kanada dhe transportuar drejt Shqipërisë e më pas Kosovës, duke përdorur automjete të blera në Kanada dhe të modifikuara për fshehjen e lëndës narkotike.

Në operacionin e 22 gushtit, policia sekuestroi rreth 80 kg kanabis, të ndarë në 127 pako dhe të fshehur në një automjet të transportuar në kontejner detar. U arrestuan tre shtetas të Kosovës, ndërsa dy persona të tjerë, një nga Kukësi dhe një shtetas kosovar me banim në Kanada, u shpallën në kërkim. Më 28 gusht, në operacionin "Suitcases", në Rinas u kapën rreth 46 kg kanabis në 89 pako, të fshehura në dy valixhe. U arrestua një 34-vjeçar dhe u proceduan penalisht dy gra. Ndërsa më 9 shtator, në Portin e Durrësit u sekuestruan edhe 107.7 kg "Gelato", me vlerë të përllogaritur rreth 1.2 milionë euro, të fshehura në hapësira të modifikuara të një kamperi. Në këtë rast u shpallën në kërkim dy persona.

Sekuestrimet në Shqipëri vijnë në një kohë kur autoritetet europiane kanë evidentuar rritje të trafikut të kanabisit nga Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara drejt Europës. Sipas Agjencisë së Bashkimit European për Drogat (EUDA), gjatë vitit 2025 në portet e Antverpit dhe Roterdamit u sekuestruan rreth 21 tonë kanabis bimor në secilin port, me ngarkesat që vinin kryesisht nga Kanadaja. Në maj të këtij viti, autoritetet britanike kapën 12 tonë kanabis të nisur nga Kanadaja në Portin e Southampton-it, ndërsa autoritetet kanadeze kanë raportuar gjithashtu sekuestrime të sasive të mëdha me destinacion vende të BE-së. Për autoritetet, këto raste tregojnë një ndryshim në rrugët e furnizimit të tregut europian të kanabisit, me përdorimin në rritje të kontejnerëve dhe automjeteve tregtare për transportin e ngarkesave nga Amerika e Veriut drejt Europës.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

[Puno me ne!](#)[Marketing](#)[Politika e privatësisë](#)[Rreth Nesh](#)[Kushtet e përdorimit](#)[Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.